

## Thirrje për Programin e Praktikave për Biznese

Ftojmë të gjithë bizneset që vijnë nga fushat e **përpunimit të pemëve dhe perimeve, përpunimit të qumështit, përpunimit të mishit, përpunimit të drithërave dhe thertoreve** nga Rajoni Lindor për të marrë pjesë në programin për praktikë të projektit “Të rinjtë në Agrobiznes- Regjioni Ekonomik Lindor.”

Projekt është i financuar nga Bashkimi Evropian, menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe zbatuar nga Komuna e Gjilanit si palë kryesore, në bashkëpunim me komunat: Kaçanik, Hani i Elezit, Viti, Shtërpçë, Partesh, Kllokot, Ranillug, Kamenicë dhe Novobërdë.

Bizneset mund të marrin maksimum pesë praktikantë me pagesë për tre muaj, projekti “Te rinjtë në Agrobiznes- Regjioni Ekonomik Lindor” do të mbulojë pagesat e tyre mujore kështu që bizneset e zgjedhura nuk kanë obligime financiare ndaj praktikantit.

Prioritet kanë bizneset që kanë më shumë se dy vjet përvojë në përpunimin e pemëve dhe perimeve, përpunimin e qumështit, përpunimin e mishit, përpunimin e drithërave dhe thertoreve.

Praktikantët do të përzgjidhen në bashkëpunim me bizneset.

Në këtë program të praktikave do të përfshihen **100 të rinj ku: 30 do të jenë në përpunimin e pemëve dhe perimeve, 30 në përpunimin e qumështit, 15 në përpunimin e mishit, 15 në përpunimin e drithërave dhe 10 në thertore.**

Programin për praktikë për të rinjtë do t'i ndihmojë bizneset të gjejnë praktikantët e duhur për bizneset e tyre.

Bizneset e interesuar duhet të aplikojnë në linkun e mëposhtëm:

ENG: <https://goo.gl/forms/5JvD6bCdsQHmqGDA2>

ALB: <https://goo.gl/forms/Rsla1B5T7iGxhzxQ2>

SRB: <https://goo.gl/forms/SA5Z73oLhXLNWRGX2>

Ose përmes dorëzimit të aplikacionit në Zyrën e Kryetarit, Bulevardi i Pavarësisë, pn, Gjilan

**Perioda e Aplikimit: 21 Janar 2019- 21 Shkurt 2019**